



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 81, Datë 02.05.2024**

**MBI**

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR.155, DATË 07.10.2020,  
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “MATEO&CO” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MURASI”, ME KAPACITET  
TË INSTALUAR 2000 KW, NË LUMIN E CEMIT TË SELCËS, DEGË E LUMIT CEM I  
BASHKUAR, NË BASHKINË MALËSI E MADHE, QARKU SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.05.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 60/2 prot., datë 30.04.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr.155, datë 07.10.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Murasi”, me kapacitet të instaluar 2000 kW, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, Qarku Shkodër”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 155, datë 07.10.2020, ka vendosur:
  1. Të licencojë shoqërinë “MATEO&CO” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Murasi”, me kapacitet prodhues 2000 kW, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i Bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, Qarku Shkodër, për një afat 30-vjeçar.
  2. Shoqëria “MATEO&CO” sh.p.k., të bëjë me dije ERE-n mbi ecurinë e procesit të rinovimit si dhe të depozitojë në ERE çdo dokument/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, jo më vonë se 1 muaj pas rinovimit të tyre.
  3. Mos plotësimi i kushtit të parashikuar në pikën 2 të këtij vendimin përbën shkak për rishikimin e vendimit nga ERE.

- Për sa lënë kusht në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 155/2020, shoqëria duhet të depozitohet në ERE: *lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujq sipërfaqësor brënda datës 09.04.2022, dhe Kontratën e qirasë me nr. 6418 prot., datë 08.10.2018, të nënshkruar midis Bashkisë Malësi e Madhe, në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit, e depozituar nga ana e shoqërisë me herët në ERE në kuadër të pajisjes me licencë, e cila ka përfunduar në datën 08.10.2023.*
- Në lidhje me plotësimin e kushteve të sipër cituara është ndjekur një korrespondencë e gjatë me shoqërinë me shkresat (nr. 386 prot., datë 18.03.2022, nr. 849 prot., datë 26.05.2022, nr. 1397 prot, datë 11.05.2023, nr. 2429/1 prot., datë 21.11.2023). Gjatë kësaj kohe është zhvilluar dhe një seancë dëgjimore me qëllim sqarimin/shterimin e procesit të pajisjes me këto leje.
- ***Për sa i përket kushtit për depozitim të lejes së rinovuar të përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor*** nga ana e shoqërisë me shkresat (nr. 386/1 prot., datë 08.04.2023, nr. 2429/2 prot., datë 11.12.2023) është depozituar informacioni në lidhje me aplikimet e bëra në datën 22.03.2022, 07.11. 2022, 25.09.2023 këto aplikime janë refuzuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore (AMBU) për mangësi dokumentacioni, së fundi shoqëria pasi ka plotësuar detyrat e lëna nga AMBU ka ri aplikuar në datën 04.03.2024, po ashtu ajo ka bërë me dije se për gjithë këtë periudhë që është në fazë aplikimesh/trajtimesh për rinovimin e lejes është faturuar dhe ka paguar detyrimet/tarifat rregullisht për përdorimin e burimeve ujqore.
- Në korrespondencat e zhvilluara me AMBU me shkresat (nr.1397/1 prot., datë 19.05.2023, nr. 1928/2 prot., datë 06.10.2023, nr. 633 prot., datë 15.02.2024), (nr.1928/3 prot., datë 18.10.2023, nr.633/1 prot., datë 22.02.2024), në të cilat AMBU ka dhënë sqarimet respektive gjithashtu ka bërë me dije se subjekti është në fazën e trajtimit të aplikimeve të kryera.
- Nga korrespondencat me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Muras” i shoqërisë “MATEO&CO” sh.p.k. nuk rezulton të ketë një vendim për mos ushtrim veprimtarie.
- Si e tillë duke ju referuar aplikimit të fundit të depozituar nga shoqëria i bërë në datën 04.03.2024 vlerësojmë t’i lihet një afat për depozitim të lejes së rinovuar sipas kohës së trajtimeve dhe të rasteve të tjera nga AMBU e cila në komunikimet e mëparshme ka sqaruar se, *pavarësisht se vlerësimi progresiv i afateve të vendosura në dispozitat në fuqi është mesatarisht rreth 90 ditë.*
- Për sa më sipër referuar dokumentacionit të depozituar nga shoqëria, korrespondencës me AMBU dhe IKMT vlerësojmë që pika 2 e dispozitivit të ndryshojë ***duke i lënë detyrimin shoqërisë që të depozitohet në ERE lejen e përdorimit të burimit ujq deri më datën 03.06.2024.*** Po ashtu pas pikës 2 të shtohet pika 3 me përmbajtjen: ***nëse subjekti ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit***

*(IKMT) atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në depozitim e lejes së rinovuar për përdorimin e burimit ujq sipërfaqësor.*

- *Për sa lënë kusht në pikën 2 të vendimit të bordit shoqëria ka pasur detyrimin të depozitohet në ERE, Kontratën e qirasë të rinovuar me Bashkinë Malësi e Madhe, e cila e ka pasur afatin e vlefshmërisë deri në datën 08.10.2023. Në lidhje me plotësimin e këtij kushti është zhvilluar korrespondencë me shoqërinë me shkresat e referuara më sipër dhe sa trajtuar edhe në seancën dëgjimore ku u sqarua modaliteti i vijimit për ndjekjen e dokumentacionit pronësor, në të u referua se do të vijohet edhe me regjistrimin e kontratës me MIE-n në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK). Në zbatim të plotësimit të kushtit të lënë në pikën 2, shoqëria me shkresën nr. 60/1 prot., datë 02.04.2024 ka depozituar kontratë e qirasë me nr. 632 prot., datë 29.02.2024 e lidhur mes shoqërisë “Mateo & Co” sh.p.k. dhe Bashkisë Malësi e Madhe “Për dhënien në përdorim (qira) të fondit pyjqor/kullosor publik”, me afat 10 vjeçar me të drejtë rinovimi.*
- *Në vijim të sa depozituar nga shoqëria është plotësuar kushti i vendosur në pikën 2, si i tillë vlerësohet që në dispozitiv të shtohet pika 4 pasi përcaktimi i pikës dy është ndryshuar, pika 4 do ketë përmbajtjen: *shoqëria të depozitohet në ERE kontratën e rinovuar me Malësinë e Madhe “Për dhënien në përdorim (qira) të fondit pyjqor/kullosor publik”, brenda datës 01.03.2034, ose Certifikatën e Lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon të drejtën e përdorimit të pronës në zonën ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s:

#### **Vendosi:**

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 155, datë 07.10.2020, ndryshon dhe bëhet:
  2. *Shoqëria “MATEO&CO” sh.p.k. duhet të depozitohet në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Murasi” brenda datës 03.06.2024.*
2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtje si më poshtë:
  3. *Nëse subjekti ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtarë i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në depozitim e lejes së rinovuar për përdorimin e burimit ujq sipërfaqësor.*
3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me përmbajtje si më poshtë:
  4. *Shoqëria “MATEO&CO” sh.p.k. duhet të depozitohet në ERE, Kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Malësi e Madhe brenda datës 01.03.2034, ose Certifikatën e Lëshuar*

*nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) që rregullon të drejtën e përdorimit të pronës në zonën ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike.*

4. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me përmbajtjen si më poshtë:

*5. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit të kushteve të tij.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE NË DETYRË**

**Erjola SADUSHI**